



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria për Zhvillim Rural

THIRRJE PËR APLIKIM

I. Përkrahje në blegtori – pagesa direkte

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës, të cilët posedojnë gjedhe qumështore, buallica si dhe kafshë të imëta - dele dhe dhi, se mund të aplikojnë për pagesa direkte (subvencione) në lëmin e blegtorisë.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

Përkrahen fermerët që kanë:

- 3 - 10 krerë gjedhe (lopë qumështore);
- 3 - 10 krerë buallica (buallica qumështore);
- 20 -150 krerë dele;
- 20 - 150 krerë dhi;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara;
- Përfituesi duhet të jetë banorë i Komunës së Prishtinës;
- Objekti (stalla) të jetë në territorin e Komunës së Prishtinës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi i llogarisë bankare;
- Vërtetim nga shërbimet veterinarë;
- Numri identifikues i fermerit (NIF).

II. Përkrahje në bletari – pagesa direkte

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës, të cilët posedojnë bletë, se mund të aplikojnë për pagesa direkte (subvencione) në lëmin e bletarisë.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Përkrahen bletarët që kanë 10 – 29 shoqëri bletësh;
- Bletarët duhet t'i kenë të vendosura bletët vetëm në një bletore;
- Përfituesi duhet të jetë banorë rezident i Komunës së Prishtinës dhe të ketë bletoren në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Përfituesi – bletarët duhet të kenë të shenjzuar kosheret (shtëpizat e bletëve);
- Numri identifikues i fermerit (NIF) duhet të jetë i vendosur në shabllon, në përmasat 30 x 12 cm, në trupin e kosheres, jo në kapak, i shënjuar me ngjyrë të përhershme.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi i llogarisë bankare;
- Numri identifikues i fermerit (NIF).

III. Përkrahje në shpezëtari-pagesa direkte

Ftohen të gjithë fermerët (person juridik) e fermave komerciale që posedojnë pula vojse në territorin e Komunës së Prishtinës, se mund të aplikojnë për pagesa direkte (subvencione) në lëmin e shpezëtarisë.

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Aplikuesi duhet të ketë fermën (objektin) në territorin e Komunës së Prishtinës dhe të jetë banorë i tij;
- Përfitues mund të jenë fermerët (person juridik) e fermave që kanë 2000 deri 6000 copë pula për vezë;
- Ferma duhet të jetë e regjistruar.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e çertifikatës së biznesit;
- Certifikata e numrit fiskal
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar (përfaqësues i biznesit);
- Konfirmimi i llogarisë bankare;

- Dëshmi për numrin dhe origjinën e pulave vojse (faturën);
- Dëshmi mbi gjendjen shëndetësore të pulave të lëshuar nga autoriteti kompetent (AUVK).

Data për aplikim prej 21.03.2024 deri më 05.04.2024, aplikimi bëhet në të gjitha sportelet e Qendrës për Shërbime me Qytetar.

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit.